



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	22.07.2025
NR/BR.	01. 199/25
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim –Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me nr. 01. Nr.109 të datës 30.09.2019 i plotësuar-ndryshuar sipas vendimit me nr. 01 Nr. 22 datë 28.03.2025

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës përmes Komitetit për Politikë dhe Financa i propozon Kuvendit të Komunës të marrë:

VENDIM

Për;

1. Plotësim Ndryshimin e Vendimit me nr. 01. Nr.109 të datës 30.09.2019 përmes së cilit është bërë këmbimi i pronës së Komunës dhe subjektit juridik Organizata Komunale e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës.
2. Pika IV e Vendimit me nr. 01. Nr.109 të datës 30.09.2019 i plotësuar sipas vendimit me nr. 01 Nr. 22 datë 28.03.2025 ndryshohet vetëm për sa i përket afatit të pagesës së qirasë ashtu që afati prej 3 viteve ndryshohet si në vijim; Komuna e Ferizajt Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës do të paguaj qiranë deri në përfundim të ndërtimit të objektit të Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës.
3. Obligohet Drejtoria e Financave që të paguaj të gjitha obligimet-qirat e mbetura sipas vendimit 01. Nr.109 të datës 30.09.2019 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Pikat tjera të vendimit nr. 01. Nr.109 të datës 30.09.2019 të cilat nuk preken nga ky propozim mbasin në fuqi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave.
6. Ministria e Financave me shkresën e datës 29.04.2025 me nr. 020-1051/20 ka kërkuar nga Komuna e Ferizajt vendimin me nr. 109 të datës 30.09.2019 sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të shqyrtuar ligjshmërinë.

Të bashkangjitur gjeni;

- Vendimin e Kuvendit të Komunës me nr, 01. Nr.109 të datës 30.09.2019.
- Shkresën nga Ministria e Financave.